



Prishtinë: 29.04.2014

Kodi i ZRRE-së: V_626_2014

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 8, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.6, neni 14, paragrafi 2, nën-paragrafi 2.14 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.03/L—185);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1097_02_14**;
- Ankesa e konsumatorit e datës 14.03.2014.

në seancën e mbajtur më datë 29 prill 2014, nxorri këtë:

V E N D I M

- I REFUZHET** ankesa e konsumatorit R. H. me shifër DPR 208487 nga Prishtina ndaj vendimit të DMK-së.
- II MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. ZRRE/DMK_V_1097_02_14 i datës 27.02.2014.

Arsyetim

Me datë 05.02.2012 KEK-u i ka dërguar konsumatorit faturën mujore të energjisë elektrike në vlerë financiare **161.17 €**, me datë 07.12.2012 faturën mujore të energjisë elektrike në vlerë financiare **132.84 €**, dhe me datë 03.02.2013 faturën mujore të energjisë elektrike në vlerë financiare **70.28 €**.

Me datë 16.02.2012, 23.02.2012, 13.11.2012, 10.12.2012 dhe 07.02.2013, konsumatori ka parashtruar ankesë në Departamentin për konsumator në KEK duke kundërshtuar faturat janar dhe nëntor 2012, si dhe janar 2013 për shkak të leximit dhe faturimit jo të saktë.

Me datë 07.12.2012 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 07779878: TL=14560 kWh (tarifa e lartë) dhe TU=4433 (tarifa e ulët) kWh.

Me datë 08.02.2013 punëtorët e autorizuar të KEK-ut për inspektimin e pikave matëse kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit ku kanë evidentuar gjendjen e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin elektrik nr. 07779878: TL=15334 kWh dhe TU=4684 kWh.

Konsumatori pas marrjes së përgjigjes së KEK-ut me datë 16.07.2013 ka parashtruar ankesë në Departamentin për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE duke kontestuar faturat e muajit 12/2011, 01/2012, 10/2012, 11/2012 dhe 01/2013.

Baza e kundërshtimit të konsumatorit të theksuara në ankesë është se vendimi i DMK/ZRRE-së nuk është shqyrtuar mirë dhe drejt, pasi që sipas mendimit tim harxhimet mujore të miat kanë qenë prej 27 € deri në 35 €, kurse në disa fatura është bërë gabim ku është shënuar 9, 62€ e në disa 161.17€, 70,28€, 8,65€ dhe 132,84€ku me këtë rast kërkon nga Bordi i ZRRE-së të rishqyrtoi edhe njëherë këtë vendim.



Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29 prill 2014 ka analizuar të gjitha dëshmitë e paraqitura nga ana e KEDS-it, si dhe dëshmitë e paraqitura nga ana e konsumatorit, dhe pas vlerësimit të gjitha këtyre shkresave ka vërejtur se DMK, ka vepruar konform dispozitave ligjore që janë në fuqi me rastin e marrjes së këtij vendimi. Bordi i ZRRE-së ka vërejtur se në shkresat e lëndës Departamenti i faturimit në KEK me datë 27.02.2012 përmes urdhër lejimit numër 39956DPR-208487 ka bërë korrigjimin e faturave 11-12/2011 dhe 01/2012 në vlerë **(-19.11€)**, me datë 17.12.2012 përmes urdhër lejimit numër 11120DPR-208487 ka bërë korrigjimin e faturave 10-11/2012 në vlerë **(-22.81€)**, si dhe me datë 21.06.2013 përmes urdhër lejimit numër 52304DPR-208487 ka bërë korrigjimin e faturave 11-12/2009, 01-04/2010, 12/2012 dhe 01/2013 në vlerë **(-65.73€)**. DMK bazuar në shqyrtimin e korrigjimeve konstaton se KEK sha ka gabuar kur ka bërë korrigjimin e faturave 11-12/2011 dhe 01/2012 përmes urdhër lejimit numër 39956DPR-208487 në vlerë **(-19.11€)**, pasi që konsumatorit duhet t'i korrigojohet vetëm në periudhën 12/2011 dhe 01/2012 në vlerë **(-12.31€)** dhe jo t'i behet shpërndarja/korrigjimi për tre muaj sepse në periudhën nëntor 2011 konsumatori ka matje të saktë të shpenzimit mujor.

Gjithashtu vërehet se korrigjimi i faturave për periudhën 11-12/2009, 01-04/2010 është bërë bazuar në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik nr. 052122 të datës 21.05.2010. Sipas të dhënave të evidentuara në procesverbalin nr. 0376381 gjendja e shpenzimeve të regjistruara në njehsorin nr. 17725421 ka qenë TL=13011 kWh dhe TU=14777 kWh. Të dhënat e evidentuara në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik nuk përputhen me të dhënat e shpenzimeve të regjistruara në CCP pasi që në periudhën 04/2010 gjendja e shpenzimeve në CCP është TL=12952 kWh dhe TU=15043 kWh, kurse në vërtetimin mbi ndërrimin e njehsorit elektrik është TL=13011 kWh dhe TU=14777 kWh, e që paraqet një ndryshim në tarifën e ulët prej **266 kWh**, përkatësisht konsumatori është ngarkuar me më shumë **kWh** se gjendja reale në njehsorin elektrik, e që vërteton se është faturuar pa matje. KEK sha në këtë rast ka bërë shkelje të nenit 23 të Rregullës për Kushtet e Përgjithshme të Furnizimit me energji duke mos bërë korrigjimin e nevojshëm me rastin e identifikimit dhe mos përputhjes së të dhënave në CCP pa kërkesë të konsumatorit.

Bordi i ZRRE-së ka vlerësuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka prezantuar asnjë provë të vetme me të cilën e vërteton faktin se vendimi i DMK-së nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligj, andaj si të tilla nuk paraqesin bazë të mjaftueshme për prishjen e këtij vendimi.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 29.04.2014 ka analizuar ankesën e konsumatorit dhe vendimin e nxjerr nga DMK nr. ZRRE/DMK_V_1097_02_14, dhe pas analizimit të hollësishëm të të gjitha dëshmimeve tjera të prezantuara në shkresat e lëndës ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.



Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimin të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së

Enver Halimi, kryesues

Merita Kostari, anëtare

Krenar Bujupi, anëtar